



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

---

Numri i lëndës: 2019:284659  
Datë: 22.04.2024  
Numri i dokumentit: 05603590

K.Dh.Sh.II.nr.1072/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” ShPK me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2114/19 të datës 20.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.2114/19, i datës 20.12.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.2114/19, të datës 20.12.2021, në pikën I të dispozitivit aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” SHPK me seli në Prishtinë, në pikën II të dispozitivit anulohet aktvendimi me nr.07.3/189, 81-2016 i datës 31.07.2019 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë. Në pikën III të dispozitivit obligohet e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 11,454.51€ (njëmbëdhjetë/mijë/e/katërqind/e/pesëdhjetë/e/katër/euro/e/pesëdhjetë/e/një/cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-3868/01.03.2016 dhe R-1850/02.02.2016, të proceduar në Zyrën Doganore Intereuropa.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar në ligj, të prishet aktgjykimi A.nr.2114/19 i datës 20.12.2021 si i pa bazuar në ligj, të

refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar ne ligj dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar ose t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.07.3/189, 81-2016 të datës 31.07.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë NTP “Ardi”- Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimeve nr.R-3868/01.03.2016 dhe R-1850/02.02.2016 të Zyrës Doganore Intereuropa.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë, t'ia kthej shumën prej 11,454.51€ (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër euro e pesëdhjetë e një cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-3868/01.03.2016 dhe R-1850/02.02.2016, të proceduar në Zyrën Doganore Intereuropa. Gjykata e shkallës së parë vendimin e vet e ka mbështetur në dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës si dhe në ekspertizën financiar të datës 18.10.2021, nga ku është konstatuar se vlera e përgjithshme e obligimeve për pagesë si rezultat i rivlerësimit doganor është 11,454.66€. Po ashtu është konstatuar se vlera e mallit e faturuar nga eksportuesi është paguar sipas transaksioneve bankare të datës 28.01.2016 ku është përfshirë vlera e faturës PLS16008 dhe transaksionit bankar të datës 24.12.2015 ku është përfshirë fatura PLS15065. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se të gjitha këto dokumente janë të harmonizuara sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të

drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se e paditura ne aktvendimin e kontestuar ka dhënë sqarimet e nevojshme mbi bazën e të cilave ka ardhur deri te rivlerësimi i mallit, ku si referencë janë përdoruar mallrat e ngjashme me karakteristika të njëjta, të bazuara në sistemon Cognos dhe Asycuda. Këto pretendime Kolegji i kësaj gjykate e refuzon si të pa bazuar, pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga Dosja e Vlerës dhe zhdoganimet e mëhershme për mallrat e ngjashëm, në bazë të të cilit vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga dosja e vlerës apo zhdoganimet e mëhershme, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se “Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që “Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”. Pretendimi tjetër i të paditurës se paditësi nuk kishte prezantuar deklaratën eksportuese nga shteti dërgues i mallit, prandaj vlera me mallit siç është deklaruar nga subjekti nuk paraqet vlerën reale të mallit për qëllime doganore, për kolegjin e kësaj gjykate nuk është i bazuar, sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet që deklarata eksportuese është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore, për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të

paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.1072/22, me datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari  
Dren Rogova